

MARRVESHJA 'YS' E VITIT 2001

Kërkesat Proçeduriale

1. *Informimi i të gjithë personelit dhe zyrave që kryejnë shërbime për Nxënësit që Mësojnë Anglisht (ELLs) mbi Standardet e Programit ESOL.*
2. *Mbikëqyrja dhe monitorimi i zbatimit, ndjekjes së Standardeve të Programit.*
3. *Vlerësimi i Programit*

2.1. *Vlerësim i brendshëm: vlerësim vjetor mbi efektivitetin e programit: 01/02*

2.2. *Vlerësim i jashtëm:*

- çdo tre vjet, duke filluar jo më vonë se viti 03/04 ose
- angazhimi i një eksperti(ëve) të jashtëm në mënyrë të vazhdueshme
- kërkohet mendimi i avokatit të paditësve, lidhur me ekspertët e jashtëm që do të merren për vlerësim
- raportim në kohë rreth këtij vlerësimi (Shtatorin e vitit të vlerësimit)
- shpërndarja e raportit anëtarëve të Bordit
- dhënia e raportit paditësve me kërkesën e këtyre të fundit

4. *Raportimi*

- *Të paktën njëherë në vit të dalë raporti për çdo shkollë, ku të përfshihen: Të dhënat statistikore për nxënësit që mësojnë Anglisht (ELLs), të ndara sipas nivelit gjuhësor ESOL, sipas klasës/vitit dhe gjuhës amtare (të paktën në 6 gjuhët më të folura).*
- *Raporti të jetë i kuptueshëm për prindërit dhe ata të kenë mundësi të njihen me të.*
- *Individë dhe komunitetet organizative, që kanë lidhje direkt me arsimin, të kenë mundësi të njihen apo të dinë ku të marrin këtë raport.*

5. *Burimet: që të përmbushin standardet e programit duhet*

- *Të jenë të barabarta në nivel Drejtorie, për secilën lëndë mësimore, dhe deri në njësitë shkollore*
- *Të mos ketë reduktime disproporcionale të këtyre burimeve*

6. *Proçesi i zgjidhjes së problemeve si më poshtë:*

- *Drejtori i shkollës*
- *Një anëtar personeli jashtë shkollës (emri, numri i telefonit vihen në dispozicion)*
- *Një anëtar personeli nga Zyra e Kryetarit për Çështjet Akademike, CAO (emri, numri i telefonit)*
- *Anëtarët e personelit duhet të flasin në gjuhët përkatëse të nxënësve, ose të kenë mundësi të kontaktojnë me përkthyes të këtyre gjuhëve.*

7. *Afati i Marrëveshjes: deri në Qershor 2009*

8. *Të tjera:*

- *Paditësve dhe avokatëve të tyre u jepet mundësia për takime, me kërkesën e tyre.*
- *Përcaktimi klasor (grupit) të paditësve, deklarata e të drejtave ligjore, mundësia e njohjes/përdorimit të dokumenteve nga paditësit mbeten të njëjta, si në Marrëveshjen Provizore për Përmirësim (*Interim Remedial Agreement*).*

STANDARDET E PROGRAMIT MBI SHËRBIMET PËR NXËNESVE QË MESOJNE ANGLISHT

Nxënësit që mësojnë Anglisht (ELLs), duke pasur ndihmën dhe mundësitë e duhura, do të jenë në gjendje të plotësojnë kërkesat e Drejtorisë Arsimore të Kalimit të Klasës dhe Diplomimit.

PERVOJAT ME TE MIRA

VLERESIMI: Metodat e vlerësimit dhe modelet e programit duhet të jenë metoda apo modele që kanë rezultuar efektive. Programet duhet të përfshijnë vlerësimet e kryera në fillim dhe ato në vazhdimësi, lidhur me aftësitë gjuhësore të Anglishtes, përdorimin e treguesve të shumtë të vlerësimit gjatë gjithë kohës dhe krijimit të lehtësirave për nxënësit.

MESIMDHENIA: Nxënësit kanë të drejtë që të marrin lehtësisht informacionin mbi këto modele të programit, të cilat janë projektuar për zhvillimin e aftësive gjuhësore të tyre dhe përmbushjes së standardeve të shtetit të PA dhe të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias (SDP), ashtu si edhe të kenë lehtësira në marrjen e mësimave të lëndëve me përmbajtje (të dyta) në një gjuhë të kuptueshme dhe me metodat e duhura mësimore. Në mënyrë që të arrihen këto standarde, programet e mësimdhënies duhet të kenë kohëzgjatjen e mjaftueshme, materialet e nevojshme për krijimin e një mjedisi të pasur letrar dhe mbështetjen e duhur në kryerjen e mësimdhënies në gjuhën amtare, në rast se është e nevojshme.

PROGRAME TE TJERA: Aktivitetet jashtëshkollore, programet magnet (programet në shkollat magnet për nxënësit e talentuar), komunitetet e vogla të mësimi brenda shkollës e të tjera duhet t'u japin të gjithë nxënësve mundësi të barabarta, me asistencë dygjuhësh, nëse është e nevojshme, për sigurimin e një pjesëmarrje më të mirë. Efektiviteti i programit do të sigurohet duke bërë analizat e të dhënave, treguar përvojën më të mirë dhe nëpërmjet modifikimeve në program.

SHËRBIMET MBESHTETËSE: Nxënësit kanë të drejtë të marrin shërbime mbështetëse në mënyrë të barabartë si psh. shërbime këshillimi nga asistentët dygjuhësh, nëse është e nevojshme. Këto standarde duhet të përmbushen edhe nga nxënësit me aftësi të kufizuara, vetëm në raste kur është përcaktuar ndryshe në IEP-në e tyre.

KOMUNIKIMI ME PRINDËRIT

Informacioni që ka të bëjë me prindërit, si p.sh. njoftimet lidhur me aktivitetet e ndryshme në shkallë drejtorie do të përkthehen në gjashtë gjuhët më të folura. Shërbimet dygjuhësore me përkthim dhe interpretim do t'ju ofrohen familjeve, kur është e nevojshme, në mënyrë që ato të kuptojnë njoftimet, kërkesat e kalimit të klasës dhe diplomimit dhe të marrin pjesë aktivisht në mbledhjet, takimet me prindër, këshillin e prindërve të shkollës dhe në aktivitetet jashtëshkollore. Prindërit dhe familjet do të inkurajohen të mbështesin zhvillimin e shkrimit dhe këndimit në gjuhën amtare të nxënësit.

Prindërit do të marrin njoftim, të paktën një herë në vit, mbi Standardet e Programit për shërbimet që marrin Nxënësit që Mësojnë Anglisht dhe rreth procesit të zgjidhjes së problemeve që ata mund të ndjekin, nëse do të jenë të pakënaqur me këto shërbime.

PERSONELI SHKOLLOR

Drejtoria do të rekrutojë, punësojë dhe do të mbajë në organikën e saj personel të mjaftueshëm dhe të kualifikuar, përfshirë këtu punonjësit dygjuhësh, për të siguruar se këto standarde janë përmbushur. Drejtoria arsimore do të përcaktojë aftësitë e duhura dhe njohuritë që duhet të zotërojë secila kategori e mësuesve (qofshin këta psh. para profesional, mësues, këshilltar psikolog të shkollës, administrator, kryetarët e komisionit të lëndëve, personel i zyrës qendrore të arsimit dhe anëtarët e Bordit), të cilët janë angazhuar në shërbim të nxënësve që mësojnë Anglisht si gjuhë të dytë. Drejtoria arsimore do të përcaktojë dhe sigurojë llojet dhe sasinë e aktiviteteve që nevojitet për kualifikim profesional të personelit mësimor, kërkesë kjo për të zhvilluar, ruajtur dhe ngritur nivelin cilësor të aftësive të tyre në mënyrë të vazhdueshme.